



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.138 dt.02.10.1998

**PER
PERCAKTIMIN E PAGES BAZE MUJORE**

Këshilli i Bashkisë së Tiranës, në mbledhjen e tij dt.02.10.1998, pasi shqyrtoi materialin e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik në Bashki “Relacion mbi përcaktimin e pagës bazë të anëtarëve të Këshillit Drejtues në Parkun e Transportit Urban të Udhëtarëve Tiranë”, mbështetur në ligjin Nr.7852, dt.13.07.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.214, dt.28.03.1998 “Për disa ndryshime”, në vendimin e KM Nr.345, dt.10.08.1992 “Për shpërblimin e pagave të punonjësve”,

VENDOSI

1. Paga mujore bazë e drejtorit të Parkut të Transportit të Udhëtarëve Tiranë të jetë 29.000(njëzet e nëntëmijë)lekë.
2. Në varësi të pagës së drejtorit përcaktohen pagat e anëtarëve të tjerë të Këshillit Drejtues të kësaj ndërmarrje.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik të Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi me dt.1 Shtator 1998.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI